



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 60, datë 24 .12. 2012

P Ë R

"KRIJIMIN E QENDRËS KOMUNITARE SHKOZË DHE MIRATIMIN E STRUKTURËS SË SAJ ORGANIZATIVE SI DHE NJË SHITESË NË NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË QENDRËS SOCIALE "TË QËNDROJMË SË BASHKU", QENDRËS SOCIALE MULTIDISCIPLINARE DHE QENDRËS SOCIALE "SHTËPIA E PËRBASHKËT"

Në mbështetje të nenit 10, pika 3/II, gërma "c", nenit 32, gërma "ç" dhe "d" të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për "Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore" (i ndryshuar); nenit 121, pika 1, nenit 124, pika 1, nenit 125, nenit 126, pika 1 dhe nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar); ligjit nr.9355, datë 10.03.2005 për "Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore" (i ndryshuar), ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar); nenit 5, shkronja "a" dhe "b" të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për "Kompetencat për caktimin e pagave të punës" (i ndryshuar), vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1619, datë 02.07.2008 për "Klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore" (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr.610, datë 12.09.2007 për "Transferimin e pasurive, troje dhe objekte, me interes vendor, në pronësi të Bashkisë së Tiranës" (i ndryshuar); udhëzimit të Ministrisë Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta nr.1547, datë 27.8.2009 për "Nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike, rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror", vendimit të Këshillit Bashkiak nr.11, datë 05.04.2012 për "Ristrukturimin e Qendrës Sociale të Qëndrojmë së Bashku, "Qendrës Komunitare Multidisiplinare për Fëmijët dhe Familjet në Nevojë" dhe "Qendrës Komunitare për të Moshuarit", miratimin e strukturave të tyre organizative si dhe rishpërndarjet në Buxhetin e Bashkisë së Tiranës për vitin 2012"; vendimit të Këshillit Bashkiak nr.4, datë 01.03.2012 për "Krijimin e Qendrës Sociale "Shtëpia e Përbashkët" dhe miratimi i strukturës organizative", me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshillit Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë krijimin e "Qendrës Komunitare Shkozë" me vendodhje në një prej ambienteve të kompleksit të Banesave Sociale në pronësi të Bashkisë së Tiranës (sipas genplanit Bashkëlidhur).
2. Kalimin kapital të objektit me sipërfaqe 200 m2 dhe vlerë kontabile 6.465.399 lekë "Qendrës Komunitare Shkozë".

3. Në zbatim të pikës 1 të këtij vendimi, të miratohet struktura organizative e Qendrës Komunitare Shkozë sipas organogramës (bashkëlidhur), si dhe niveli i pagave për punonjësit e Qendrës Komunitare Shkozë sipas lidhjes së pagave nr.9, bashkëlidhur, pjesë përbërëse të këtij vendimi.
4. Efektet financiare të zbatimit të pikës 3 të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Qendrës Komunitare Shkozë për vitin 2013.
5. Të miratojë shtesën e numurit të punonjësve të Qendrës Sociale “Të Qëndrojmë së Bashku”, Qendrës Sociale Multidisiplinare dhe Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët”, sipas organogramave bashkëlidhur.
6. Efektet financiare në zbatim të pikës 5 të këtij vendimi, do të përballohen nga buxheti përkatës i Qendrave Sociale: “Të Qëndrojmë së Bashku”, Qendrës Sociale Multidisiplinare dhe Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët”, për vitin 2013.
7. Pika 5 e vendimit të Këshillit Bashkiak nr.11, datë 05.04.2012 për “Ristrukturimin e Qendrës Sociale Multidisiplinare për Fëmijët dhe Familjet në Nevojë dhe Qendrës Komunitare për të Moshuarit, miratimin e strukturave të tyre organizative si dhe rishpërndarjet në buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2012” dhe pika 2 e vendimit të Këshillit Bashkiak nr.4, datë 01.03.2012 për “Krijimin e Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët” dhe miratimi i strukturës së tyre organizative”, revokohen.
8. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimit Social, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Qendra Sociale: “Të Qëndrojmë së Bashku”, Qendra Sociale Multidisiplinare, Qendra Sociale “Shtëpia e Përbashkët”, dhe Qendra Komunitare Shkozë, për zbatimin e këtij vendimi.
9. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI